



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 gusht 2014
Nr.ref.:AGJ700/14

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO119/14

Parashtrues

Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga këta 30 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Hashim Thaçi, Xhavit Haliti, Hajredin Kuçi, Enver Hoxhaj, Arsim Bajrami, Memli Krasniqi, Margarita Kadriu-Ukelli, Zenun Pajaziti, Elmi Reçica, Rafet Rama, Ganimete Musliu, Selviqe Halimi, Safete Hadërgjonaj, Bekim Haxhiu, Flora Brovina, Fadil Beka, Xhevahire Izmaqu, Agim Aliu, Sala Berisha-

Shala, Agim Çeku, Besim Beqaj, Raif Qela, Naim Fetahu, Blerta Deliu-Kodra, Mexhide Mjaku-Topalli, Adem Grabovci, Azem Syla, Nuredin Lushtaku, Nezir Çoçaj dhe Kadri Veseli (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës e kanë autorizuar z. Xhavit Halitin për t'i përfaqësuar ata në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Vendimin Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur gjatë seancës konstituive të Kuvendit, më 17 korrik 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit, më 17 korrik 2014, me të cilin z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu siç është aplikuar gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014, duke pretenduar se ka pasur shkelje të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe të Rregullores së punës të Kuvendit.
5. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e Seancës Konstituive të Kuvendit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesit e kërkesës pretendonin se *"Masa e Përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe demokracinë në Republikën e Kosovës"*.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.5 të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 18 korrik 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 21 korrik 2014, në mbështetje të rregullit 33 të Rregullores së punës, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendim Nr. GJR. KO119/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KO119/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të

përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

9. Më 21 korrik 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi nga një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës, Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshme: Qeveria në detyrë) dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Këtij të fundit i është kërkuar të dorëzojë në Gjykatë një kopje të transkriptit nga seanca konstituive e mbajtur më 17 korrik 2014 dhe t'u ofrojë nga një kopje të kërkesës KO119/14 secilit deputet në mënyrë që atyre t'u mundësohet t'i dorëzojnë Gjykatës komentet lidhur me kërkesën.
10. Më 23 korrik 2014, Gjykata miratoi kërkesën e parashtruesve për Masë të përkohshme *"[...] deri në publikimin e vendimit përfundimtar dhe jo më vonë se 18 shtator 2014 nga nxjerrja e [...]"* vendimit për Masë të përkohshme.
11. Më 29 korrik 2014, 67 deputetë të Kuvendit dorëzuan komentet e tyre në lidhje me kërkesën KO119/14.
12. Më 30 korrik 2014, një kopje të komenteve të 67 deputetëve të Kuvendit, Gjykata ia dërgoi parashtruesve të kërkesës, të cilët nuk dorëzuan ndonjë koment.
13. Më 30 korrik 2014, deputeti z. Arsim Bajrami dorëzoi komentet e tij në lidhje me kërkesën KO119/14.
14. Më 31 korrik 2014, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ia dorëzoi Gjykatës dokumentet e kërkuara.
15. Më 4 gusht 2014, 5 deputetë të Kuvendit e njoftuan Gjykatën se i mbështesin komentet e 67 deputetëve të Kuvendit.
16. Të njëjtën datë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës komentet e deputetëve të Kuvendit në lidhje me rastin KO119/14.
17. Më 19 gusht 2014, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi në rastin e gjyqtarit Kadri Kryeziu, me ç'rast Gjykata vendosi:

TË QORTOJË gjyqtarin Kadri Kryeziu për shkeljen e nenit 1 dhe 4 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese; dhe,

TË PËRJASHTOJË gjyqtarin Kadri Kryeziu nga pjesëmarrja në seancat shqyrtuese për të gjitha kërkesat e ardhshme të Gjykatës Kushtetuese, ku përfshihen partitë politike apo individët në parti politike, apo nga çdo rast tjetër që ka kontekst politik, ku, inter alia, një palë mund të paraqitet para Gjykatës, siç është: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, Avokati i Popullit dhe komunat.

18. Rrjedhimisht, gjyqtari Kadri Kryeziu nuk ka marrë pjesë në procedurë dhe në vendimmarrje të Gjykatës për rastin KO119/14.

19. Më 21 gusht 2014, Gjykata mbajti seancë dëgjimore publike.
20. Në të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi në këtë rast, ndërsa gjyqtari raportues, gjyqtari Robert Carolan, kërkoi të zëvendësohej, sepse ai ishte pakicë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të rregullave 60 (1) dhe 44 (4) të Rregullores së punës, e zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues si gjyqtar raportues (Vendimi Nr. GJR. KO119/14). Rrjedhimisht, gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua anëtare e Kolegjit shqyrtues (Vendimi Nr. KSH. KO119/14).

Përmbledhje e fakteve

21. Më 7 maj 2014, Kuvendi, në seancë të jashtëzakonshme, vendosi për shpërndarjen e Kuvendit.
22. Më 8 maj 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës dekretoi zgjedhjet e parakohshme për t'u mbajtur më 8 qershor 2014.
23. Më 8 qershor 2014, u mbajtën zgjedhjet në Republikën e Kosovës.
24. Më 27 qershor 2014, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm: KQZ) publikoi rezultatet e zgjedhjeve.
25. Më 4 korrik 2014, KQZ-ja certifikoi rezultatet e zgjedhjeve.
26. Më 7 korrik 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës vendosi që seanca konstituive e Kuvendit të mbahet më 17 korrik 2014.
27. Më 8 korrik 2014, ish-Kryetari i Kuvendit nga legjislatura IV, ftoi në një takim të përbashkët Kryesinë e Kuvendit nga legjislatura IV, si dhe udhëheqësit e partive parlamentare, me qëllim të përgatitjes së seancës konstituive të legjislaturës V. Në ftesën për takim ishin të bashkëngjitura materialet nga KQZ-ja, përkatësisht njoftimi për rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve, Vendimi i KQZ-së Nr. 1579-2014, i 4 korrikut 2014, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe lista e kandidatëve të zgjedhur për Kuvend.
28. Më 11 korrik 2014, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe NISMA e informuan ish-Kryetarin e Kuvendit nga legjislatura IV që deputetët e subjektit politik LDK-AAK-NISMA kanë vendosur të formojnë grupin parlamentar LDK-AAK-NISMA.
29. Më 12 korrik 2014, ish-Kryetari dhe Kryesia e legjislaturës IV mbajtën takimin me qëllim të përgatitjes së propozim-rendit të ditës për seancën konstituive.
30. Propozim-rendi i ditës për seancën konstituive të Kuvendit, përmbante këto çështje:
 - a. Formimi i Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve të deputetëve;
 - b. Dhënia e betimit të deputetëve të Kuvendit;
 - c. Njoftimi për formimin e grupeve parlamentare; dhe

ç. Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.

31. Më 17 korrik 2014, Kuvendi mbajti seancën konstituive të kryesuar nga deputetja më e vjetër e Kuvendit, znj. Flora Brovina, (në tekstin e mëtejshëm: Kryesuesja) dhe e ndihmuar nga deputetja më e re e Kuvendit, znj. Teuta Rugova.
32. Kryesuesja hapi seancën konstituive të Kuvendit dhe pastaj kërkoi nga partitë politike që secila të propozojnë nga një anëtar për Komisionin *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) propozoi deputetin z. Memli Krasniqi, LDK-AAK-NISMA propozoi deputetin z. Armend Zemaj, Vetëvendosje propozoi deputeten znj. Albulena Haxhiu, Lista Srpska propozoi deputeten znj. Jelena Bontić, Kosovo Demokratik Tyrk Partisi e propozoi deputeten znj. Müfera Şinik, Koalicioni VAKAT propozoi deputetin z. Duda Balje, Progresivna Demokratska Stranska propozoi deputeten znj. Emilija Redžepi, Partia Liberale Egjiptiane e propozoi z. Etem Arifi, Kosovaki Nevi Romani Partia propozoi deputetin z. Kujtim Paqaku. Kjo përbërje e Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve u votua dhe u miratua nga të gjithë 120 deputetët.
33. Komisioni *ad hoc* paraqiti raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve dhe verifikoi kuorumin e seancës konstituive të Kuvendit, bazuar në listën e rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve sipas renditjes në vijim:
 - a. PDK - 37 deputetë
 - b. LDK - 30 deputetë
 - c. VV - 16 deputetë
 - ç. AAK - 11 deputetë
 - d. Srpska Lista - 9 deputetë
 - dh. NISMA - 6 deputetë
 - e. Kosovo Demokratik Tyrk Partisi - 2 deputetë
 - ë. Koalicija Vakati - 2 deputetë
 - f. Progresivna Demokratska Stranka - 1 deputet
 - g. Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës - 1 deputet
 - gj. Nova Demokratska Stranka - 1 deputet
 - h. Partia Liberale Egjiptiane - 1 deputet
 - i. Partia e Ashkalinjëve për Integrim - 1 deputet
 - j. Koalicija za Gora - 1 deputet
 - k. Kosovaki Nevi Romani Partia - 1 deputet
34. Pas kësaj, Kryesuesja deklaroi se që të gjithë 120 deputetët ishin të pranishëm dhe vuri në votim raportin e Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe mandateve, ku 44 deputetë votuan “për”, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve nuk votuan as “kundër”, e as nuk abstenuan. Pastaj, Kryesuesja bëri një pauzë.
35. Pas pauzës, Kryesuesja zhvilloi një tjetër raund të votimit. Kryesuesja deklaroi se që të gjithë 120 deputetët ishin të pranishëm dhe se, nga ata deputetë të pranishëm, 117 deputetë votuan “për” raportin e Komisionit *ad hoc*.
36. Kryesuesja kërkoi nga deputetët e pranishëm dhënien e betimit, gjë të cilën ata e bënë.

37. Sa i përket pikës 3 të rendit të ditës – Formimi i grupeve parlamentare – Kryesuesja deklaroi se ajo dhe deputetja më e re e Kuvendit nuk kishin kompetenca formale në lidhje me atë pikë dhe se ato ishin aty vetëm falë moshës së tyre. Prandaj, ajo theksoi se formimi i grupeve parlamentare duhet të bëhet pas pikës 4 të rendit të ditës, pas zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit.
38. Kryesuesja vazhdoi me rendin e ditës për seancën konstituive të Kuvendit, duke kërkuar nga PDK-ja që të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit dhe nga duke kërkuar nga tri partitë më të mëdha politike që t'i propozojnë kandidatët e tyre për nënkryetarë të Kuvendit. PDK-ja propozoi deputetin z. Agim Aliu kandidat për Kryetar të Kuvendit, kurse LDK-ja propozoi deputetin z. Isa Mustafa kandidat për Kryetar të Kuvendit. Partitë e tjera politike nuk propozuan kandidatë të tyre për nënkryetarë të Kuvendit. Kur Kryesuesja e vuri në votim kandidimin e PDK-së z. Agim Aliun, partitë politike në vijim: LDK, VV, AAK, NISMA dhe Lista Srpska e lëshuan sallën e Kuvendit. Me kërkesë të saj, u numëruan deputetët e mbetur. Të pranishëm ishin 47 deputetë. Kësisoj, Kryesuesja e shpalli seancën të mbyllur deri në njoftimin tjetër me shkrim, sepse më nuk kishte kuorum.
39. Pastaj, edhe pse seanca konstituive e Kuvendit zyrtarisht ishte pezulluar nga Kryesuesja deri në njoftimin tjetër me shkrim, LDK, AAK, NISMA, VV dhe Lista Srpska u kthyen në sallën e Kuvendit dhe filluan një mbledhje. Deputetja më e re e Kuvendit, znj. Teuta Rugova, e kryesoi mbledhjen dhe kërkoi nga 83 deputetët e pranishëm të votojnë mocionin e paraqitur nga LDK, AAK, NISMA dhe VV për zëvendësimin e Kryesueses, deputetes znj. Flora Brovina. Mocioni u miratua me 82 vota "për". Rrjedhimisht, deputetja e dytë për nga moshën, deputetja znj. Milka Vulić, mori kryesimin e mbledhjes.
40. Znj. Milka Vulić kërkoi nga LDK, AAK dhe NISMA të propozojnë një kandidat për Kryetar të Kuvendit dhe kërkoi nga tri partitë politike më të mëdha që secila të propozojë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. LDK, AAK dhe NISMA propozuan deputetin z. Isa Mustafa kandidat për Kryetar të Kuvendit, ndërsa VV propozoi deputetin z. Glauk Konjufca kandidat për nënkryetar të Kuvendit dhe Grupi 6+ propozoi kandidatë për nënkryetar të Kuvendit, mbi bazën e rotacionit, deputetët: znj. Duda Balje, z. Müfera Şinik, z. Danush Ademi dhe z. Kujtim Paqaku. Partitë e tjera politike deklaruan se kandidatët e tyre për nënkryetarë të Kuvendit do t'i propozojnë në një fazë të mëvonshme.
41. Znj. Milka Vulić i vuri kandidatët në votim, me ç'rast z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit me 65 vota "për", nga gjithsej 83 deputetë të pranishëm. Z. Glauk Konjufca nga VV u zgjodh nënkryetar me 82 vota "për", ndërsa znj. Duda Balje, znj. Müfera Şinik, z. Danush Ademi dhe z. Kujtim Paqaku nga Grupi 6+ u zgjodhën nënkryetarë, mbi bazën e rotacionit, me 82 vota "për".

Argumentet e paraqitura nga parashtuesit

42. Parashtuesit e kërkesës pretendojnë se *"Gjatë përgatitjes për Mbledhjen Konstituive të legjislaturës së V-të të Kuvendit dhe gjatë mbajtjes së kësaj mbledhje ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së*

Kuvendit. Gjatë mbledhjes, me datën 12.07.2014, nga kryesuesi i mbledhjes, Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, z. Krasniqi, pati tejkalim të kompetencave të tij që dalin jashtë mandatit të përcaktuar në Kushtetutë, gjegjësisht interpretimit të tij për Grupin më të madh parlamentar gjegjësisht sipas ish-kryetarit "Grupi Parlamentar" i formuar me 47 deputetë gjatë procesit të regjistrimit të deputetëve të Legjislaturës së V-të, duhet të ulet në qendër dhe si rrjedhojë ky Grup Parlamentar duhet edhe të propozojë Kryetarin e Kuvendit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që "Grupi Parlamentar LDK-AAK-NISMA" nuk janë certifikuar si Grupi më i madh parlamentar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, siç është përcaktuar në Nenin 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 / 15 qershor 2008), veprimi i Kryetarit të Kuvendit nga Legjislatura e IV, që ka autorizuar bashkimin në një Grup Parlamentar të deputetëve të LDK-së, AAK-së dhe NISMA, pa u certifikuar si Grupi më i madh parlamentar, para konstituimit të Legjislaturës së V -të të Kuvendit të Republikës së Kosovës përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 64 (1) dhe Nenit 67 si dhe Nenit 15 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / nr. 31 /15 qershor 2008). Gjithashtu, veprimet e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura IV, bie ndesh edhe me praktikën e deritanishme që konfirmohen me Transkriptin nga Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit me përfaqësuesit e partive parlamentare, të mbajtur më 10.02.2011."

43. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 17 korrik 2014 (Nr. 05-V-00 I), për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe procedurën përgatitore të ndjekur në lidhje me procesin e konstituimit të Kuvendit, nuk është në përputhje me Dispozitat e Nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 67.2 të Kushtetutës, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO 103/14 të parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së Nenit 84 (14) (Kompetencat e Presidentit) me nenin 95 (Zgjedhja e Qeverisë) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Nr. Ref: AGJ 671/14, 1 korrik 2014), Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar i cili ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend dhe zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit."
44. Kësisoj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të përgjigjet në këto çështje:
 - a. Të vlerësohet kushtetutshmëria e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës 17.07.2014 (nr. 05-V-001) nëse Kryetari i Kuvendit është propozuar nga grupi më i madh parlamentar sipas nenit 67.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
 - b. Të sqarohet cili është Grupi më i madh parlamentar, që është përcaktuar në Nenin 67 (Paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 12 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës (29 prill 2010) gjegjësisht a është Grupi Parlamentar që ka fituar në zgjedhjet për Kuvendin të datës 8 qershor 2014 apo grupimi

i cili është formuar gjatë regjistrimit të deputetëve dhe si rrjedhojë: Kush ka të drejtë të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit në mbledhjen konstituive të Kuvendit?

- c. *Të sqarohet a ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit nga legjislatura e mëparshme, sipas nenit 67.7. Cilat janë kompetencat e Kryetarit të Kuvendit nga legjislatura e mëparshme gjatë mbledhjes përgatitore të datës 12.07.2014?*
- ç. *Pas mbylljes zyrtare të mbledhjes konstituive a ka pas të drejtë që të shkarkohet Kryesuesja e Seancës dhe të vazhdohet me mbajtjen e mbledhjes pa u ftuar anëtarët si dhe duke marrë parasysh këtë dhe hapat që kanë pasur me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit a ka pasur gjatë mbajtjes së mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës a ka pasur shkelje të Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit?*

Komentet e paraqitura nga 67 deputetë të Kuvendit

- 45. *Më 29 korrik 2014, 67 deputetë, përfaqësuar nga z. Bajram Gecaj, parashtruan komentet e tyre në lidhje me kërkesën KO119/14.*
- 46. *Sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, 67 deputetët pretendojnë që parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në bazë të nenit 131.5 të Kushtetutës, për arsye se "[...] shkeljet e pretenduara të Parashtruesve janë çështje të parapara me Rregulloren e Kuvendit ose përcaktuara me Vendimin e Kryesisë së Kuvendit, por jo çështje të rregulluara me Kushtetutë". 67 deputetët argumentojnë se Gjykata ka marrë qëndrim në Rastin Nr. KO29/11 dhe në Rastin Nr. KO108/13 "[...] ku, Gjykata nuk ka pranuar të interpretojë çështje të parapara me Rregulloren e Kuvendit, por vetëm ato të parapara me Kushtetutë".*
- 47. *Në këtë drejtim, 67 deputetët pretendojnë që:*
 - a. *nocionin "grupi më i madh parlamentar" "[...] e përkufizon Rregullorja e Kuvendit në Shtojcën nr. 1 të saj. Rrjedhimisht, në përputhje me qëndrimin e qartë të kësaj Gjykate që nuk lëshohet në interpretime të çështjeve të parapara me ligje ose në rregullore, as në rastin konkret, Parashtruesit e Kërkesës nuk mund të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese interpretimin e çështjeve që rregullohen me Rregulloren e Kuvendit dhe jo me Kushtetutë, respektivisht, interpretim të përkufizimit të dhënë në Shtojcën 1 të Rregullores së Kuvendit. [...]" dhe "Përkufizimi i termi "grup parlamentar" është çështje politike, sepse lidhet ngushtë me vullnetin politik të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për të rregulluar, nëpërmes Rregullores së Kuvendit, procedurat e funksionimit të këtij institucioni si dhe veprimtarisë së tyre si deputetë."*
 - b. *Vendimi i Kryesisë së Kuvendit nuk është çështje kushtetuese dhe nga rasti Nr. KO115/13 "Është qëndrim i qartë i kësaj Gjykate se nuk merret me interpretimin e vendimeve të Kryesisë së Kuvendit apo të*

trupave tjerë të Kuvendit, por vetëm me vendime të votuara nga deputetët në Seancë”.

48. Në rastin konkret, LDK-AAK-NISMA kanë formuar një grup të përbashkët parlamentar bazuar në ngjashmëritë programore të tyre dhe kanë ushtruar të drejtat e tyre si grupe parlamentare, duke propozuar kandidatin për Kryetar të Kuvendit, në përputhje me nenin 67 (2) të Kushtetutës.
49. Sipas mendimit të 67 deputetëve, parashtruesit e kërkesës në asnjë mënyrë nuk precizojnë se si mund të paraqesin shkelje kushtetuese pretendimet e tyre. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar sqarime, që nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
50. Sa i përket meritave të kërkesës, 67 deputetët pretendojnë se kërkesa është e pabazuar, sepse *“Të dy kërkesat esenciale të Kushtetutës [dmth. Neni 67.2 i Kushtetutës], pra propozimi nga grupi më i madh parlamentar dhe votimi nga shumica e deputetëve të Kuvendit, janë plotësuar në rastin konkret. Të gjitha çështjet e tjera janë çështje të rregulluara me Rregulloren e Kuvendit”.*
51. Sa i përket nocionit “grup parlamentar”, 67 deputetët konsiderojnë se ky nocion nuk përcaktohet në Kushtetutë, por në Rregulloren e punës të Kuvendit, Shtojca 1 [Përkufizimi i shprehjeve të përdorura në këtë Rregullore], ku thuhet si vijon: *“grupim i së paku 5 për qind, përkatësisht i 6 deputetëve të Kuvendit, që i kanë njoftuar Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit për qëllimin e tyre të veprojnë si grup parlamentar.”* Ata, po ashtu, i referohen nenit 20 (1) të Rregullores së punës, ku përcaktohet që *“Deputetët mund të formojnë Grup Parlamentar sipas përkatësisë së tyre partiake ose të përcaktimeve programore”*, ndërsa paragrafi 2 parasheh se *“deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në një grup parlamentar, të tërhiqet nga grupi, ta formojë një grup të ri parlamentar, t’i bashkëngjitet një grupi tjetër ose të veprojë si deputet i pavarur. Për secilin rast deputeti është i obliguar që, për vendimin e tij, ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit”.*
52. Lidhur me këtë, 67 deputetët pretendojnë se *“Më datë 8 korrik 2014, Grupi prej 47 deputetëve formuan grupin parlamentar LDK, AAK, NISMA duke u bazuar në përcaktimet programore dhe për këtë, në përputhje me nenin 20 të Rregullores, e njoftuan Kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit, që ishte në detyrë, në përputhje me nenin 8 të Rregullores së Kuvendit. Në asnjë mënyrë nuk mund të kontestohet formimi i grupeve parlamentare para mbajtjes së seancës konstituive, për arsye se nëse i referohemi nenit 8 (3) të Rregullores, shihet qartë se grupet mund të formohen edhe para seancës konstituive. Ky qëndrim është edhe në përputhje me nenin 70 (2) të Kushtetutës [...]”* dhe *“Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare janë certifikuar me dt. 4 korrik 2014 nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërkaj seanca konstituive është mbajtur më 17 korrik 2014. Bazuar në këtë, deputetët, të cilëve tashmë u kishte filluar mandati 13 ditë para seancës konstituive, kishin të drejtë dhe liri për t’u bashkuar në grupe parlamentare edhe para seancës konstituive. Formimi i grupeve parlamentare edhe para seancës konstituive dëshmohet edhe me precedente të mëhershme të praktikës parlamentare. Në legjislaturën IV të Kuvendit të Kosovës, certifikimi i rezultateve ishte bërë më 7 shkurt 2011, ndërkaj Grupi parlamentar 6+ e kishte dorëzuar listën e deputetëve të grupit*

të tyre parlamentar (që bashkonte parti të ndryshme që kishin garuar ndaras në zgjedhje), më 9 shkurt 2011, ndërsa seanca konstituive u mbajt më 21 shkurt 2011”.

53. Në anën tjetër, 67 deputetët theksojnë se parashtuesit e kërkesës po ashtu gabimisht konstatojnë që grupi parlamentar është sinonim me nocionin “parti ose koalicion”. Sipas mendimit të tyre, “grupi më i madh parlamentar” nuk përcaktohet nga partia politike apo koalicioni, por nga vullneti i lirë i deputetëve për t’u bashkuar qoftë bazuar në përkatësinë politike, qoftë në atë programore, siç përcaktohet në Rregulloren e Kuvendit.
54. Sa i përket kërkesës së parashtuesve të kërkesës që Gjykata të sqarojë se a ka pasur shkelje të Kushtetutës nga Kryetari i legjislaturës së mëparshme gjatë takimit përgatitor të 12 korrikut 2014, 67 deputetët pretendojnë se Gjykata nuk ka kompetenca të shqyrtojë vendimet e Kryesisë së Kuvendit, por vetëm vendimet e marra në seancë nga shumica e deputetëve. Sipas mendimit të tyre, *“[...] ky ka qenë Vendim i Kryesisë, pa asnjë votë kundër, pra i marrë me konsensus dhe me kuorum të mjaftueshëm për të marrë vendime. Duke marrë këtë vendim, Kryesia ka vepruar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit, sepse, siç u sqarua më sipër, Kryesia e legjislacionit të mëparshëm vazhdon mandatin deri në zgjedhjen e Kryetarit të legjislaturës së re, përfshirë këtu edhe marrjen e vendimeve rreth Seancës Konstituive”.*
55. Për më tepër, sa i përket pretendimit të parashtuesve të kërkesës se ka pasur shkelje me rastin e zëvendësimit të Kryesueses, 67 deputetët argumentojnë që kjo *“[...] nuk është një çështje me të cilën duhet të merret Gjykata, pasi që është e përcaktuar me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe jo me Kushtetutë. Është e qartë që të gjitha rregullat e përfshirë [në Rregulloren e punës së Kuvendit], që ndër të tjera përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e deputetëve, vlejnë për çdo seancë. Pra, nga momenti i dhënies së betimit, deputetët kanë pasur të drejtë t’i gëzonin të drejtë të shfrytëzojnë të gjitha të drejtat, përfshirë të drejtën për të kërkuar fjalën, për të votuar pro e kundër, për të kërkuar vazhdimin e seancës, për të kërkuar pauzë, për të paraqitur mocione apo për ta ndërruar Kryesuesen, në përputhje me dispozitat e parapara në Rregullore”.*
56. Gjashtëdhjetë e shtatë deputetët pretendojnë se ata kanë kërkuar zëvendësimin e Kryesueses në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit, në dritën e asaj që vijon:
 - a. *“[...] përkundër vendimit të Kryesisë që në ulëset e mesme të ulen deputetët e Grupit Parlamentar LDK AAK NISMA, deputetët e PDK-së kishin uzurpuar këto ulëse. Në emër të Grupit Parlamentar LDK AAK NISMA, deputetja Vjosa Osmani kërkoi fjalën nga kryesuesja për të kundërshtuar këtë shkelje, por Kryesuesja e Seancës nuk ia dha fjalën. [...] Të njëjtin kundërshtim, rreth shkeljes së Vendimit të Kryesisë sa i përket ulëseve në Kuvend, e shprehi edhe deputeti Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Përkundër këtij kundërshtimi, Kryesuesja e Seancës nuk reagoi për ta rregulluar shkeljen e Vendimit të Kryesisë të datës 12 korrik 2014.”*

- b. “[...] Kryesuesja e seancës ka tentuar ta ndërpres seancën, përkundër vullnetit të deputetëve (mbi 2/3 të tyre) për ta vazhduar atë. Ajo dhe deputetët e tjerë të PDK-së u larguan nga salla, ndërkaq mbi 2/3 e deputetëve qëndruan në sallë, me kërkesën që seanca të vazhdojë. Në momentin që Zëvendësja e Kryesueses, Teuta Rugova, ka kërkuar të verifikohet kuorumi dhe pastaj të vazhdohet seanca, duke ftuar deputeten tjetër më të vjetër, meqë znj. Flora Brovina refuzonte të udhëhiqte seancën, Flora Brovina është rikthyer në sallë dhe ka uzurpuar ulësen e Kryesueses, duke mos lejuar as vazhdimin e seancës, as diskutime, as votim e asnjë veprim tjetër. Ajo kështu ka mbajtur peng mbi 2/3 e deputetëve të Kuvendit, duke iu përgjigjur vetëm kërkesës së PDK-së që seanca të mos vazhdohej.”
- c. “Pika e tretë e rendit të ditës, e cila përcaktonte njoftimin rreth formimit të grupeve parlamentare, u kalua në mënyrë arbitrare nga Kryesuesja e seancës [...]” sepse “[...] nëse askush në seancë nuk ka kundërshtime për Rendin e Ditës në fillim të seancës, ai Rend konsiderohet i miratuar dhe nuk mund të ndryshohet më (neni 42.2 i Rregullores së Kuvendit). Për çdo shmangie nga ky Rregull dhe nga Rregullorja e Kuvendit kërkohen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm (Neni 84 i Rregullores së Kuvendit), por një votim i tillë nuk ka ndodhur fare.”
- ç. “Kur arriti të pika e katërt e rendit të ditës, në përputhje me skenarin e përgatitur nga Sekretariati në lidhje me mbarëvajtjen e seancës, ajo ishte e obliguar që fjalën t’ia jap grupit më të madh parlamentar, dmth. grupit LDK-AAK-NISMA, që të propozojë Kryetarin e Kuvendit, në bazë të Kushtetutës (Neni 67.2), të Rregullores së punës së Kuvendit (Neni 8 dhe 12), të përfundimit të Kryesisë, dhe të skenarit të përgatitur nga Sekretariati i Kuvendit. Megjithatë, ajo i shkeli të gjitha këto dokumente, dhe se pari ia dha fjalën grupit parlamentar të PDK-së me vetëm 37 deputetë, për dallim nga grupi parlamentar LDK-AAK-NISMA me 47 deputetë.”
57. Në fund, 67 deputetët “Në përputhje me Rregullin 39 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese [...] kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të urdhërojnë mbajtjen e Seancës dëgjimore, meqë kjo është më se e nevojshme për të qartësuar provat e kësaj lënde, veçanërisht të transkriptit të seancës konstituive të Kuvendit. Një Seancë dëgjimore është esenciale, sepse Transkripti bëhet bazuar në deklaratimet e dhëna me mikrofon të hapur me urdhër të Kryesueses së Seancës, përderisa Kryesuesja ka hapur mikrofonin vetëm për deputetët e partisë së saj (PDK) dhe nuk i ka hapur mikrofonin deputetëve të tjerë parashtrues të këtyre Komenteve, por ata janë deklaruar në Kuvend pa mikrofon dhe kanë kërkuar vazhdimisht që të mbahet procesverbal mekanik për shkak të këtyre rrethanave bllokuese nga Kryesuesja e Seancës, Flora Brovina. Për më tepër, ka nevojë që palët (përfaqësuesit e grupeve parlamentarë në Kuvend dhe Sekretaria e Administratës së Kuvendit) të paraqesin qëndrime të tyre jo vetëm për transkriptin, por edhe për dokumente dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e Seancës.”

Komentet e paraqitura nga deputeti i Kuvendit, z. Arsim Bajrami

58. Më 30 korrik 2014, deputeti z. Arsim Bajrami parashtroi komentet e tij në Gjykatë në lidhje me Kërkesën KO119/14. që janë përmbledhur si në vijim:

- a. *“Përfundimi i Kryesisë së legjislaturës së mëparshme (datë 12.07.2014) për ndarjen e vendeve në Kuvend, i nënshkruar nga Kryetari i legjislaturës së mëparshme z. Jakup Krasniqi, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 64.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse sipas këtij vendimi ndarja e ulëseve në Kuvend nuk u bë në bazë të votave të fituara gjatë zgjedhjeve për Kuvendin, por në bazë të numrave dhe koalicioneve paszgjedhore, që nuk ishin të regjistruara në KQZ, sipas Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme nr. 031L-073 , nenit 15 dhe 18. Pashmangshëm, përmes mënyrës së ndarjes së vendeve, është shkelur edhe praktika e deritashme parlamentare, por njëherit edhe vullneti i sovranit që ishte transmetuar gjatë zgjedhjeve [...]”.*
- b. *“Në mbledhjen e datës 12 Korrik 2014, Kryesia e legjislaturës së mëparshme qëllimisht e ka injoruar faktin se asnjë nga deputetet e legjislaturës së pestë, përfshirë edhe ata te grupimit paszgjedhor LDK-AAK-NISMA nuk e kanë dhënë betimin solemn dhe rrjedhimisht nuk e gëzojnë të drejtën juridike dhe kushtetuese që ta ushtrojnë funksionin e tyre si deputetë. Edhe pse mandati i deputetit fillon me ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve (neni 70.2), deputeti i zgjedhur nuk mund ta ushtrojë detyrën e deputetit para konstituimit të Kuvendit, gjegjësisht dhënies së betimit. Kjo është arsyeja pse në rregulloren e punës, sekuenca e ngjarjeve në seancën konstituive fillon me përgatitjet për seancë (neni 8), verifikimi i mandatit (neni 9), dhënia e betimit (neni 10) dhe zgjedhja e organeve të Kuvendit (neni 12). Po ashtu, kjo është arsyeja pse neni 70.3 e saktëson se mandati i deputetit shpallet i pavlefshëm nëse deputeti nuk e bën betimin.”*
- c. *“[...] se në ditën e konstituimit, nocioni “grup parlamentar” reflekton vetëm vullnetin e shprehur në zgjedhje dhe të gjitha partitë apo koalicionet e certifikuara, duhet të ulen sipas forcës politike, ashtu siç e kanë rezultatin nga zgjedhjet.”*
- ç. *“Vetëm pasi që deputeti ta bëjë betimin dhe të përmbushen procedurat e parapara për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Kryesisë së re të Kuvendit (neni 12 me referencë në nenin 8 të Rregullores), deputetët janë të lirë të lëvizin dhe për këtë lëvizje duhet të informojnë me shkrim Kryesinë e re të Kuvendit (neni 20.2); Grupimi paszgjedhor LDK-AAK-NISMA ka të drejtë të bashkohet në një grup të përbashkët vetëm pas seancës konstituive. Si të tillë, të njëjtit nuk kanë qenë grupi më i madh parlamentar në seancën konstituive të datës 17 Korrik 2014, andaj sipas nenit 67.2 të Kushtetutës, nuk kanë pasur dhe nuk kanë të drejtën ta propozojnë kandidatin për kryetar të kuvendit”.*
- d. *Përveç kësaj, deputeti z. Arsim Bajrami, i referohet Rregullores së punës së Kuvendit të Sllovenisë, Serbisë, Austrisë, Republikës Çeke,*

Maqedonisë, Shqipërisë, Portugalisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi, duke argumentuar që “[...] lëvizja e deputetëve dhe grupet e reja parlamentare krijohen vetëm pas seancës konstituive [...]”.

Komentet e paraqitura nga deputetja e Kuvendit, znj. Luljeta Veselaj-Gutaj

59. Më 4 gusht 2014, deputetja znj. Luljeta Veselaj-Gutaj parashtroi komentet e saj në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, *“Kontestoi procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit të Kosovës z. Isa Mustafa gjatë seancës konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik 2014, ku ka shkelje të nenit 67. Konstituimi i kuvendit nuk është zhvilluar në pajtim me nenin 67 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve), paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës dhe me Kreun III (Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit) të Rregullores së punës së Kuvendit”.*

Komentet e paraqitura nga deputetët e Grupit 6+ të Kuvendit

60. Më 4 gusht 2014, deputetët e Grupit 6+ parashtruan komentet e tyre në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, duke pretenduar se ata kanë marrë pjesë gjatë konstituimit të Kuvendit dhe se vendimet e miratuara gjatë seancës konstituive të Kuvendit janë marrë në përputhje me Kushtetutën.

Komentet e paraqitura nga deputeti i Kuvendit, z. Etem Arifi

61. Më 4 gusht 2014, deputeti z. Etem Arifi parashtroi komentet e tij në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, duke theksuar që ai ka marrë pjesë në konstituimin e Kuvendit dhe se mendimi i tij gjatë seancës konstituive është bazuar në vullnetin e tij të lirë pa asnjë presion.

Komentet e paraqitura nga deputeti i Kuvendit, z. Veton Berisha

62. Më 4 gusht 2014, deputeti z. Veton Berisha parashtroi komentet e tij në Gjykatë në lidhje me kërkesën KO119/14, duke theksuar se ai ka marrë pjesë në seancën konstituive të Kuvendit dhe se mendimi i tij gjatë seancës konstituive është bazuar në vullnetin e tij të lirë pa asnjë presion, si dhe është bazuar në njohurinë e tij për krijimin e institucioneve, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Seanca dëgjimore publike

63. Më 21 gusht 2014 Gjykata mbajti seancë dëgjimore publike, ku të pranishme ishin këto palë dhe të përfaqësuara në mënyrë të rregullt:
- a. Për parashtruesit e kërkesës: deputeti z. Arsim Bajrami;
 - b. Për respondentët/palët që janë përgjigjur:
 - i. LDK, deputetja znj. Vjosa Osmani;
 - ii. VV, deputetja znj. Albulena Haxhiu;
 - iii. AAK, z. Ardian Gjini;
 - iv. Lista Srpska, deputetja znj. Milka Vulić;
 - v. NISMA, deputetja znj. Valdete Bajrami;

- vi. Kosovo Demokratik Tyrk Partisi, deputeti z. Mahir Yagcilar;
- vii. Progresivna Demokratska Stranska, deputeti z. Nenad Rasić;
- viii. Nova Demokratska Stranka, deputetja znj. Emilija Rexhepi;
- ix. Partia Liberale Egjiptiane, deputeti z. Veton Berisha;
- x. Partia e Ashkalinjëve për Integritet, deputeti z. Etem Arifi; dhe
- xi. Kosovaki Nevi Romani Partia, deputeti z. Kujtim Paqaku.

64. Gjatë seancës dëgjimore, këto palë morën fjalë:

- a. Për parashtruesit e kërkesës: deputeti z. Arsim Bajrami;
- b. Për respondentët/palët që janë përgjigjur:
 - i. LDK, AAK dhe NISMA, deputetja znj. Vjosa Osmani dhe z. Ardian Gjini; dhe
 - ii. VV, deputetja znj. Albulena Haxhiu.

65. LDK-ja dhe VV-ja i paraqitën Gjykatës dokumente shtesë.

66. Gjykata dëgjoi parashtruesat verbale të palëve lidhur me kërkesën.

Pranueshmëria e kërkesës

67. Gjykata, së pari, shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

68. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.

69. Përkitazi me këto kërkesa, Gjykata vëren se parashtruesit kanë ngritur kërkesën e tyre në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, që përcakton si në vijim:

“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.” **[versioni serbisht dallon prej versioneve anglisht dhe shqip]**

70. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

*1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme: **[versionet shqip dhe serbisht dallojnë nga versioni anglisht]***

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.

71. Përveç emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve që parashtruan kërkesën, ata kanë cekur edhe: vendimin e kontestuar, dispozitat relevante të Kushtetutës, si dhe provat që mbështesin kërkesën.
72. Sa i përket vendimit të kontestuar, Gjykata vëren se parashtruesit kontestojnë Vendimin nr. 05-V-001, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit.
73. Sa i përket afatit kohor, Gjykata vëren se Vendimi nr. 05-V-001, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, i votuar nga 83 deputetë të Kuvendit, është miratuar më 17 korrik 2014 dhe se kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 18 korrik 2014. Rezulton që kërkesa është parashtruar brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh, siç është paraparë me Kushtetutë.
74. Gjykata konkludon se janë përmbushur kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara në nenin 113.5 të Kushtetutës dhe në nenin 42 të Ligjit.
75. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese lidhur me seancën konstituive të Kuvendit dhe prandaj nuk ka bazë për ta shpallur atë të papranueshme, apo për të hyrë në analizimin e bazave shtesë të pranueshmërisë të dorëzuara nga parashtruesit e kërkesës.

Studimi krahasimtar

76. Para se të hyjë në analizimin e rastit, Gjykata do të kryejë një studim krahasimtar të dispozitave relevante kushtetuese të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Korniza Kushtetuese) dhe të një numri të vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001

77. Në nenet 9.1.7, 9.1.8 dhe 9.1.9, Korniza Kushtetuese përcakton:

Kryesia e Kuvendit

9.1.7 Kuvendi do të ketë Kryesinë e përbërë prej tetë deputetëve të Kuvendit të cilët do të zgjedhën si vijon:

- (a) *Dy anëtarë do të emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare;*
- (b) *Dy anëtarë do të emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e dytë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;;*

- (c) *Një anëtar do të emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e tretë me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;*
- (d) *Një anëtar do të emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e katërt me radhë sa i përket numrit të votave në zgjedhjet parlamentare;*
- (e) *Një anëtar do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb dhe*
- (f) *Një anëtar do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb. Metoda për emërimin e këtij anëtari të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin komuniteteve të njëjta.*

9.1.8 Kuvendi i miraton këto emërime me anë të një vote formale.

Kryetari i Kuvendit

9.1.9 Anëtari i Kryesisë, partia ose koalicioni i të cilit ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend do të jetë Kryetar i Kuvendit.

Shqipëria

78. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 67 dhe në nenin 75, përcakton:

Neni 67

1. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmbledhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.

2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

79. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në nenin 6 dhe në nenin 15, përcakton:

Neni 6 – Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

- 1. Kandidati për Kryetar të Kuvendit propozohet nga të paktën 15 deputetë. Një deputet nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat. Propozimi bëhet me shkrim, përmban nënshkrimet përkatëse dhe paraqitet në Sekretarinë e Përkohshme të Kuvendit.*
- 2. Kryetari i Kuvendit zgjidhet pa debat dhe me votim të fshehtë, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar, vijohet me një raund të dytë, ku votohet për dy kandidaturat që kanë marrë më shumë vota.*
- 3. Votimi organizohet publikisht dhe drejtohet nga një komision votimi, i përbërë prej 5 deputetësh, që pasqyron, për aq sa është e mundur, përbërjen politike të Kuvendit. Anëtari më i ujetër në moshë kryen edhe detyrën e kryetarit të komisionit të votimit dhe shpall rezultatin e votimit.*
- 4. Drejtuesi i seancës fton menjëherë Kryetarin e Kuvendit të zërë vendin e tij.*

Neni 15 – Formimi i grupeve parlamentare

- 1. Deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik.*
- 2. Për krijimin e një grupi parlamentar kërkohet një minimum prej 7 deputetësh. Çdo deputet mund të jetë anëtar vetëm i një grupi parlamentar. Një deputet që largohet nga grupi parlamentar, mund t'i bashkohet një grupi tjetër parlamentar vetëm pas gjashtë muajve nga data e largimit.*
- 3. Kur numri i deputetëve të një grupi parlamentar bie nën numrin e parashikuar nga pika 2 e këtij neni, grupi pushon së ekzistuari.*
- 4. Brenda 3 ditëve nga data e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit, çdo deputet deklaron me shkrim se në cilin grup parlamentar bën pjesë. Vetëm deputetët që nuk bëjnë deklarinë e mësipërm ose që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar mund të formojnë grup të përzier.*
- 5. Çdo deputet ka të drejtë të largohet nga grupi parlamentar. Për këtë ai duhet t'i paraqesë një deklaratë me shkrim kryesisë së grupit dhe të njoftojë me shkrim Byronë e Kuvendit.*
- 6. Deputetët që zgjidhen gjatë legjislaturës, brenda 3 ditëve nga kryerja e betimit, bëjnë deklarinë me shkrim se cilit grupi parlamentar i përkasin.*

Bullgaria

80. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, në nenin 75 dhe në nenin 76, përcakton:

Neni 75

Kuvendi i posa zgjedhur thirret në seancën e parë nga Presidenti i Republikës brenda një muaji pas zgjedhjes së tij. Nëse Presidenti nuk e bënë një gjë të tillë, ai thirret nga ana e një të pestës së deputetëve të Kuvendit.

Neni 76

1. Seanca e parë e Kuvendit hapet nga deputeti më i vjetër i pranishëm.

2. Në seancën e parë, deputetët japin betimin si në vijim:

"Beto hem se në emër të Republikës së Bullgarisë se do të zbatojë Kushtetutën dhe ligjet e vendit dhe se të gjitha veprimet e mia do të udhëhiqen nga interesat e popullit. Beto hem."

3. Kuvendi zgjedh në të njëjtën seancë Kryetarin dhe Nënkryetarët e tij.

81. Rregullorja e Punës së Kuvendit Kombëtar të Bullgarisë, në Kapitullin II dhe në Kapitullin IV, përcakton:

Kapitulli Dy

KONSTITUIMI I KUVENDIT DHE NDRYSHIMET NË ORGANIN E KRYESIMIT

Neni 3

(1) Seanca e parë e Kuvendit hapet nga ana e deputetit më të vjetër të pranishëm. Deputeti në fjalë e kryeson atë derisa Kuvendi të zgjedhë Kryetarin e vet.

(2) Deputetët e Kuvendit e japin betimin në pajtim me nenin 76, paragrafi 2 i Kushtetutës i cili dokumentohet përmes nënshkrimit individual të betimit me shkrim.

Neni 4

(1) Nën kryesimin e deputetit më të vjetër, debatet mbahen ekskluzivisht për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit si dhe në zgjedhjen e vet tij.

(2) Në seancën e parë të Kuvendit, deputetët e miratojnë rregulloren e punës në lidhje me kushtet dhe rregullat e zgjedhjes së Kryetarit dhe Nënkryetarëve të Kuvendit.

Neni 5

(1) Kryetari dhe Nënkryetarët e Kuvendit mund të shkarkohen nga pozita para skadimit të mandatit sipas kushteve në vijim:

1. me kërkesë të tij/saj;

2. përmes një mocioni me shkrim nga jo më pak se një e treta e të gjithë deputetëve, kur ai/ajo objektivisht nuk është në gjendje të përmbush detyrat e tij/saj apo, në mënyrë të vazhdueshme, keqpërdorë autoritetin e tij/saj apo nëse dështon në kryerjen e detyrave të punës brenda kompetencave të tij/saj.

3. përmes një mocioni me shkrim nga një grup parlamentar i formuar nga ana e një partie apo koalicioni parlamentar i cili e ka nominuar atë.

(2) Nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen nga pozitat para skadimit të mandatit kur e lëshojnë grupin parlamentar i cili i ka nominuar apo me shkarkim nga ai grup.

(3) Në rastet nga pika 1 e paragrafit 1 dhe 2, shkarkimi bëhet pa debat apo votim.

(4) Në rastet nga pika 2 dhe 3 e paragrafit 1, mocioni duhet vënë në votim gjatë seancës së parë pas datës së parashtrimit duke lejuar një dëgjim të personit në fjalë. Mocioni do të konsiderohet të jetë paraqitur nëse mbështetet nga më shumë se gjysma e deputetëve të pranishëm në Kuvend.

(5) Në rast të shkarkimit sipas paragrafit 1 dhe 2, brenda 14 ditësh pas miratimit të vendimit, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e punës, duhet bërë zgjedhjen e re e cila miratohet nga ana e Kuvendit. Deri në mbajtjen e zgjedhjes së re për Kryetar të Kuvendit, ky i fundit kryesohet nga ana e Nënkryetarit të nominuar nga ana e partisë apo koalicionit të përfaqësuar parlamentar i/e cila e ka nominuar atë.

Neni 6

Kuvendi zgjedh 8 Sekretarë nga mesi i deputetëve.

Neni 7

Në seancën vijuese, Kuvendi zgjedh Komisionet e Përhershme.

Kapitulli Katër

GRUPET PARLAMENTARE

Neni 12.

(1) Deputetët e Kuvendit mund të formojnë grupe parlamentare.

(2) Grupi parlamentar duhet të përbëhet nga së paku 10 (dhjetë) deputetë.

(3) Nëse anëtarët e një grupi parlamentar dështojnë të plotësojnë numrin e kërkuar, atëherë grupi pushon së ekzistuari.

(4) Kur një grup parlamentar pushon së ekzistuari, nënkryetari i zgjedhur nga ky grup duhet të shkarkohet nga detyra para skadimit të mandatit.

Shkarkimi duhet të shpallet në seancën e parë të mundshme pa diskutim ose votim.

Neni 13.

(1) Secili grup parlamentar duhet t'i dorëzojë Kryetarit të Kuvendit një vendim për themelimin e grupit dhe një listë të udhëheqësve dhe të anëtarëve, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët.

(2) Grupet parlamentare, udhëheqësit e tyre dhe çdo ndryshim në përbërjen e tyre duhet të regjistrohet në një regjistër të posaçëm të Kuvendit.

(3) Kryetari i Kuvendit duhet të shpallë grupet parlamentare të regjistruara dhe udhëheqësit e tyre në seancën plenare. Çdo ndryshim në përbërjen e një grupi parlamentar duhet të kumtohet nga ana e Kryetarit të Kuvendit në seancën plenare.

(4) Të gjithë ndihmësit e përhershëm të një grupi parlamentar duhet të emërohen nga personeli i Kuvendit. Me kërkesë të cilitdo grup përkatës parlamentar, numri i zyrtarëve të tillë duhet të miratohet nga ana e Kryetarit të Kuvendit në raport prej 1:10 me numrin e anëtarëve të tij, por jo më pak se 2 për secilin grup parlamentar.

Neni 14.

(1) Deputetët e Kuvendit nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se një grupi parlamentar.

(2) Mandati i anëtarëve të grupit parlamentar, fillimi dhe përfundimi i tij, dhe të drejtat e detyrat e anëtarëve të grupit duhet të caktohen nga ana e grupit parlamentar përkatës në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore.

(3) Deputeti i kuvendit mund të japë dorëheqje nga grupi i tij/saj parlamentar duke i dorëzuar dorëheqjen në formë të shkruar udhëheqësit të grupit parlamentar dhe Kryetarit të Kuvendit i cili do ta njoftojë Kuvendin në seancën plenare.

(4) Me dorëheqjen nga anëtarësia në grupin parlamentar apo me shkarkim nga ai, deputeti do të humbasë vendin e tij/saj në Komisionet e Përhershme si përfaqësues i grupit parlamentar përkatës, në delegacionet e Kuvendit dhe pozitat tjera të zgjedhura në Kuvend.

(5) Deputeti i cili ka dhënë dorëheqje nga grupi parlamentar apo është përjashtuar nga grupi, do të jetë anëtar i Kuvendit pa u anëtarësuar në asnjë grup parlamentar.

(6) Anëtarët e Parlamentit të Evropës nga Republika e Bullgarisë mund gjithashtu të marrin pjesë në punën e Grupeve Parlamentare pa të drejtë vote dhe në pajtim me regjistrimin e partisë apo koalicionit pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, nga lista e të cilëve ata janë zgjedhur.

Kroacia

82. Kushtetuta e Kroacisë, në nenin 73, përcakton:

Neni 73

[...]

Parlamenti i Kroacisë konstituohet në seancën e parë me zgjedhjen e Kryetarit të tij nga shumica e deputetëve të pranishëm.

83. Rregullorja e punës e Parlamentit të Kroacisë, në Pjesën e dytë, përcakton:

Pjesa e dytë

Konstituimi i Parlamentit, Fillimi i Mandatit të Deputetëve, Pezullimi dhe Ndërprerja e Mandatit të Deputetëve në Parlament

Neni 4

Presidenti i Republikës thërret Seancën e parë Konstituive të Parlamentit.

Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit, seanca përkohësisht kryesohet nga ana e Kryetarit të Parlamentit nga mandati i kaluar, apo, nëse ai/ajo nuk ka pasur mundësi të merr pjesë, nga ana e deputetit më të vjetër të pranishëm në Parlament.

Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit, kryesuesi i përkohshëm ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e Kryetarit të Parlamentit lidhur me kryesimin e seancës.

Parlamenti konstituohet me zgjedhjen e Kryetarit në seancën e parë në të cilën janë të pranishëm shumica e deputetëve.

Pas zgjedhjes së Kryetarit të Parlamentit, ky i fundit e merr kryesimin.

Me konstituimin e Parlamentit, këndohet himni kombëtar i Kroacisë.

Neni 5

Gjatë Seancës Konstituive, Parlamenti zgjedh edhe anëtarët për Komisionin për Kredenciale dhe Privilegje.

Përveç Kryetarit të Parlamentit dhe Komisionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, gjatë Seancës Konstituive të Parlamentit mund të zgjidhen edhe Nënkryetari i Parlamentit, Sekretari i Parlamentit dhe Sekretari i Seancës së Parlamentit, Komisioni i Zgjedhjeve, Emërimeve dhe Administratës si dhe grupet tjera punuese.

Së paku 1/3 e deputetëve të zgjedhur të Parlamentit, gjatë Seancës Konstituive, kanë të drejtë që të paraqesin propozimet për zgjedhjen e organeve të përmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

Gjermania

84. Ligji Themelor i Republikës së Gjermanisë, në nenin 40, përcakton:

Neni 40 [Kryesia – Rregullorja e punës]

1. Bundestagu zgjedh Kryetarin, Nënkryetarin dhe sekretarinë. Ai miraton rregulloren e punës.

85. Rregullorja e punës e Bundestagut Gjerman përcakton:

Rregulli 1 Mbledhja konstituive

(1) Mbledhja e parë e Bundestagut të porsazgjedhur thirret nga ana e Kryetarit në largim dhe mbahet jo më vonë se ditën e trembëdhjetë pas zgjedhjes (neni 39 i Ligjit Themelor).

(2) Në mbledhjen e parë të Bundestagut, deputeti më i vjetër i Bundestagut, apo nëse ai/ajo nuk pranon, atëherë deputeti më i vjetër i radhës e merr Kryesimin deri sa Kryetari i ri apo njëri nga Nënkryetarët nuk e merr pozitën.

(3) Kryetari sipas moshës duhet të emërojë deputetët e Bundestagut që do të veprojnë si Sekretariat i përkohshëm. Pas kësaj, do të lexohen emrat e deputetëve të Bundestagut.

(4) Pas vërtetimit të kuorumit, bëhet zgjedhja e Kryetarit, Nënkryetarëve dhe Sekretarive.

Rregulli 2 Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve

(1) Bundestagu, përmes votimit të fshehtë dhe të ndarë (Rregulli 49), e zgjedh Kryetarin dhe Nënkryetarët për mandatin elektorale. Çdo grup parlamentar në Bundestagun Gjerman do të përfaqësohet në Kryesi me të paktën një Nënkryetar.

(2) Zgjedhet personi që merr votat e shumicës së deputetëve të Bundestagut. Nëse gjatë votimit të parë nuk merret shumica e votave, për votimin e dytë mund të propozohen kandidatë të ri. Nëse edhe më tej nuk është marr shumica e votave të deputetëve të Bundestagut, mbahet një votim i tretë. Nëse në votimin e tretë është vetëm një kandidat, ai/ajo zgjidhet nëse merr shumicën nga votat e hedhura. Kur ka disa kandidatë, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e tretë; zgjidhet personi që merr shumicën e votave. Në rast të barazimit, Kryetari në cilësinë e kryesuesit me short bënë tërheqjen e emrit për të vendosur se cili nga dy kandidatët do të zgjidhet.

(3) Votimet tjera që përfshijnë një kandidat të pasuksesshëm gjatë votimit të tretë lejohen vetëm me marrëveshjen e arritur nga Pleqësia. Nëse pas procedimit të pasuksesshëm sipas paragrafit (2) propozohen kandidatë të ri, atëherë fillohet përsëri me procedurën e zgjedhjes sipas paragrafit (2).

Rregulli 10 *Formimi i grupeve parlamentare*

(1) Grupet parlamentare paraqesin bashkimin e jo më pak se pesë përqind të deputetëve të Bundestagut dhe se anëtarët e tyre duhet t'i përkasin të njëjtës parti apo partive të cilat, për shkak të qëllimeve të ngjashme politike, nuk garojnë mes njëra tjetrës në ndonjë Land. Kur deputetët e Bundestagut formojnë një grup të tillë mbi baza të tjera nga ato të përmendura në fjalinë e parë të këtij paragrafi, njohja e tyre si një grup parlamentar kërkon pëlqimin e Bundestagut.

(2) Formimi i grupeve parlamentare, emërimi i tyre dhe emrat e kryesuesve, anëtarëve dhe të ftuarve duhet që në formë të shkruar t'i komunikohen Kryetarit.

(3) Grupet parlamentare mund të pranojnë të ftuar të cilët, pa llogaritur forcën politike të grupit, duhet të merren parasysh gjatë shpërndarjes së posteve (Rregulli 12).

(4) Deputetët e Bundestagut të cilët dëshirojnë të formojnë një grup por që nuk mund ta arrijnë numrin e caktuar minimal për të pasur statusin e një grupi parlamentar, mund të njihen si një grupim. Paragrafët (2) dhe (3) duhet të vlejnë për ato mutatis mutandis.

(5) Grupet punuese të përbashkëta teknike të krijuara nga ana e grupeve parlamentare nuk prekin numrin e posteve në të cilat grupet parlamentare kanë të drejtë në përputhje me fuqinë relative politike të tyre.

Greqia

86. Kushtetuta e Greqisë, në nenin 65, përcakton:

Neni 65

1. Përmes miratimit të Rregullores së vet të punës, Parlamenti përcakton mënyrën e vet të lirë dhe demokratike të punës; kjo rregullore duhet të miratohet nga ana e Plenumit siç përcaktohet në nenin 76 dhe me urdhrin nga Kryetari publikohet në Gazetën Zyrtare.

2. Parlamenti nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe anëtarët e tjerë të Kryesisë të përcaktuar me Rregulloren e punës.

3. Kryetari dhe nënkryetarët zgjidhen në fillim të çdo legjislature. Kjo dispozitë nuk vlen për Kryetarin dhe Nënkryetarët të zgjedhur nga seanca e parë e Parlamentit të Pestë Revizionar. Me rekomandimin e pesëdhjetë

deputetëve, Parlamenti mund t'i jap vërejtje Kryetarit apo ndonjë anëtar të Kryesisë e me këtë të ndërpres mandatin e tij .

87. Rregullorja e Parlamentit Helenik përcakton:

*Kryesia
(nenet 6 – 12 të Rregullores së Punës)*

Kryesia përbëhet nga:

- *Kryetari i Parlamentit Helenik*
- *shtatë (7) Nënkryetarë*
- *tre (3) Dekanë*
- *gjashtë (6) Sekretarë*

Tipar themelor i Kryesisë është përbërja e saj shumë-partiake. Për rrjedhojë, Nënkryetari i parë, i dytë dhe i tretë, dy nga Dekanët dhe katër nga Sekretarët i përkasin partisë qeverisëse; Nënkryetari i katërt, një Dekan dhe një Sekretar i takojnë partisë më të madhe opozitare; Nënkryetari i pestë dhe një Sekretar janë anëtarë të partisë së dytë opozitare më të madhe; Nënkryetari i gjashtë i përket partisë së tretë më të madhe opozitare dhe Nënkryetari i shtatë i përket asaj të katërt. Një anëtar i Kryesisë që duhet patjetër të jetë deputet i zgjedhur, nuk mund të jetë anëtar i Kabinetit (Ministër apo Nënsekretar). Nëse një anëtar i Kryesisë pajtohet të merr detyra ministrore apo si nënsekretar, atëherë ai/ajo ipso facto duhet të jap dorëheqje nga pozita.

Kryetari dhe Nënkryetarët zgjidhen në fillim të secilës legjislaturë për gjatë gjithë mandatit të saj. Mandatet e Dekanëve dhe Sekretarëve zgjasin aq kohë sa zgjatë periudha e rregullt e seancës së fundit për të cilin janë zgjedhur.

Maqedonia

88. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, në nenin 63 dhe në nenin 67, përcakton:

Neni 63

Deputetët në Kuvend zgjidhen për periudhë kohore prej katër vitesh. Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi. Mandati fillon të rrjedhë nga seanca konstituive e Kuvendit. Kuvendi i porsazgjedhur mbledhet në seancën konstituive më së voni 20 ditë pas zgjedhjeve të mbajtura. Seancën konstituive e thirr Kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme. Në qoftë se seanca konstituive nuk thirret në afatin e paraparë, deputetët vetë mbledhen dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetënjëtë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Zgjedhjet për deputetë në Kuvend mbahen në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve ose brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. [...]

Neni 67

Kuvendi nga radha e deputetëve e zgjedh Kryetarin dhe një ose më shumë nënkryetarë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. [...]

89. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në Kapitullin II, përcakton:

II. KONSTITUIMI I KUVENDIT

1. Mbledhja Konstituive e Kuvendit dhe verifikimi i mandatit të deputetëve

Neni 9

Nëse mbledhjen e parë të Kuvendit nuk e thërret Kryetari në largim, mbledhja mbahet në ditën e 21 nga dita e përfundimit të zgjedhjeve, në orën 10.00, ndërkaq të njëjtën e thërret deputeti i zgjedhur më i vjetër në moshë, nëse edhe ai refuzon ta thërrasë, kjo e drejtë i kalohet deputetit të zgjedhur të radhës për nga moshja, deri në deputetin e zgjedhur, i cili do të pajtohet që ta thërrasë mbledhjen e parë.

Deputeti i cili e ka thërritur mbledhjen e parë, kryeson me mbledhjen e Kuvendit (kryesuesi), derisa Kryetari i sapozgjedhur ose njëri prej nënkryetarëve nuk e merr detyrën.

Neni 10

Kryesuesi me mbledhjen e parë cakton dy prej deputetëve të zgjedhur, të cilët sipas nevojës e zëvendësojnë në kryesimin me mbledhjen.

Kryesuesi me apelin e deputetëve të zgjedhur e përcakton numrin e pranishëm të deputetëve të zgjedhur.

Kuvendi mund të konstituohet nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e deputetëve të zgjedhur.

Pasi të konfirmohet kuorumi, zgjidhet kryetari dhe anëtarët e Komisionit Verifikues të Kuvendit (në tekstin e më tejme: Komisioni Verifikues).

Neni 11

Mandatin e deputetëve, me propozim të Komisionit Verifikues, Kuvendi e verifikon në Mbledhjen Konstituive.

Neni 12

Kuvendi e zgjedh Komisionin Verifikues në Mbledhjen Konstituive, me propozimin e kryesuesit.

Komisioni Verifikues përbëhet prej kryetarit dhe katër anëtarëve, nga radhët e deputetëve të cilët u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Neni 13

Në bazë të raportit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për zgjedhjen e çdo deputeti, Komisioni Verifikues i paraqet Kuvendit raport me shkrim me propozim për verifikimin e mandatit të çdo deputeti veças.

Neni 14

*Kuvendi e shqyrton dhe e voton në tërësi raportin e Komisionit Verifikues.
(2) Nëse Komisioni Verifikues e konteston zgjedhjen e deputetit të caktuar, i propozon Kuvendit që ta shtyjë verifikimin e mandatit të tij. Për çdo propozim të tillë Kuvendi debaton dhe vendos veças.*

Neni 15

Kuvendi mund ta shtyjë verifikimin e mandatit të deputetit dhe me konkluzion të kërkojë që Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve t'i kryejë shqyrtimet e nevojshme për shkak të kontrollimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së zgjedhjes së zbatuar dhe brenda afatit prej 30 ditësh për këtë ta njoftojë Kuvendin.

Neni 16

Deri në marrjen e njoftimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, deputeti, verifikimi i mandatit i të cilit është shtyrë, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në seancat e Kuvendit.

Neni 17

Verifikimin e mandatit të deputetëve, të cilët janë bërë deputetë nga lista e kandidatëve për mandatin e mbetur, Kuvendi e bën në mbledhjen e parë të radhës në bazë të raportit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa me propozim të Komisionit për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit.

Neni 18

Me verifikimin e mandatit, deputeti fiton të drejta dhe detyra të përcaktuara me Kushtetutë, me ligj dhe me këtë Rregullore.

Neni 19

Deputetit të cilit i është verifikuar mandati, i lëshohet legjitimacion dhe kartelë për votim elektronik.

Në legjitimacion evidentohet e drejta e imunitetit dhe të drejta të tjera që mund të realizohen në bazë të funksionit deputet.

Rregullat më të përafërta për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e lëshimit të legjitimacioneve të deputetëve, si dhe për evidencën e legjitimacioneve të lëshuara i miraton Kryetari i Kuvendit.

Për lëshimin e legjitimacioneve dhe për evidencën e legjitimacioneve të lëshuara kujdeset Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

2. Zgjedhja e Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve

Neni 20

Kuvendi në Mbledhjen Konstituive, me propozimin e së paku dhjetë deputetëve, zgjedh Komisionin për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve.

Në Komision sigurohet përfaqësim përkatës i deputetëve të partive politike të përfaqësuara në Kuvend.

3. Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit

Neni 21

Kuvendi nga radhët e deputetëve zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.

Numrin e nënkryetarëve e përcakton Kuvendi me propozim të Kryetarit të Kuvendit. Nënkryetarët zgjidhen nga radhët e deputetëve, të cilët u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Njëri nga nënkryetarët zgjidhet nga radhët e deputetëve, të cilët i takojnë partisë politike të përfaqësuar në Kuvend, që është parti më e madhe opozitare.

Neni 22

Kandidat për Kryetar të Kuvendit mund të propozojë Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve ose së paku 20 deputetë.

Një deputet mund të jetë propozues vetëm i një kandidati për Kryetar të Kuvendit.

Neni 23

Propozimet e kandidatëve për Kryetar të Kuvendit paraqiten me shkrim në seancën e Kuvendit dhe përmbajnë emrin dhe mbiemrin e kandidatit me të dhëna biografike dhe arsyetim, si dhe emrat dhe mbiemrat e deputetëve të cilët paraqesin propozimin dhe nënshkrimet e tyre.

Radhitja e kandidatëve për Kryetar të Kuvendit përcaktohet sipas rendit alfabetik të mbiemrave të tyre.

Neni 24

Me votimin për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit udhëheq kryesuesi.

Nëse Kuvendi vendos që Kryetari i Kuvendit të zgjidhet me votim të fshehtë, kryesuesit gjatë zgjedhjes i ndihmojnë Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe tre deputetë, të cilët i zgjedh Kuvendi me propozim të kryesuesit nga radhët e deputetëve, të cilët u takojnë partive të ndryshme politike të përfaqësuara në Kuvend.

Neni 25

Deputeti ka të drejtë të votojë vetëm për njërin nga kandidatët e propozuar për Kryetar të Kuvendit. Nëse deputeti voton për më shumë kandidatë për Kryetar të Kuvendit, votimi i tij konsiderohet i pavlefshëm.

Neni 26

Për Kryetar të Kuvendit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Nëse për Kryetar propozohet një kandidat dhe nëse gjatë votimit të parë nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Nëse për Kryetar propozohen dy kandidatë, dhe nëse në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave, votimi përsëritet.

Nëse për Kryetar të Kuvendit propozohen tre ose më shumë kandidatë, votimi përsëritet për dy kandidatët, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave në votimin e parë.

Nëse mes kandidatëve me numër më të madh votash ka kandidatë me numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet për të gjithë kandidatët me numër më të madh të votave.

Në qoftë se edhe në votimin e përsëritur asnjëri nga kandidatët nuk e fiton numrin e mjaftueshëm të votave, përsëritet e tërë procedura zgjedhore.

Neni 27

Dispozitat e kësaj Rregulloreje, që kanë të bëjnë me propozimin e kandidatëve dhe zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, zbatohen edhe gjatë propozimit të kandidatëve dhe zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit.

Neni 28

Për Nënkryetar të Kuvendit zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Nëse për Nënkryetar propozohen më shumë kandidatë nga numri i cili zgjidhet, ndërsa nuk është zgjedhur numri i parashikuar, do të përsëritet votimi për zgjedhjen e atij numri të nënkryetarëve të cilët nuk janë zgjedhur edhe atë në mes kandidatëve, të cilët kanë fituar numër më të madh të votave.

Në qoftë se edhe gjatë votimit të përsëritur nuk zgjidhet numri i parashikuar i nënkryetarëve, përsëritet procedura për zgjedhjen e atyre nënkryetarëve të cilët nuk janë zgjedhur.

Nëse propozohen aq kandidatë sa është e nevojshme të zgjidhen, ndërsa nuk është zgjedhur numri i parashikuar, përsëritet e tërë procedura zgjedhore për atë numër të nënkryetarëve të cilët nuk janë zgjedhur

2. Grupet parlamentare

Neni 33

Në Kuvend themelohen grupe të deputetëve.

Grupin e deputetëve e përbëjnë së paku pesë deputetë, të cilët i takojnë njëres, apo më shumë partive politike.

Deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një grupi të deputetëve.

Grupi i deputetëve cakton koordinatortë të grupit të deputetëve dhe deri në dy zëvendës.

Grupi i deputetëve, Kryetarit të Kuvendit i paraqet listë të nënshkruar nga secili anëtar i grupit, nga koordinatori dhe zëvendësi i tij.

Grupi i deputetëve ka të drejtë në ndihmë profesionale dhe të drejtën të shfrytëzojë hapësirë të veçantë, në proporcion me numrin e deputetëve.

Për ndryshimin e përbërjes së grupit të deputetëve, koordinatortë dhe zëvendësit të tij njoftohet Kryetari i Kuvendit, i cili për këtë i njofton deputetët.

Portugalia

90. Kushtetuta e Portugalisë, në nenet: 140, 173 dhe 180, përcakton:

Neni 149 Zonat zgjedhore

1. Deputetët zgjidhen për zonat zgjedhore të cilat, gjeografikisht, përcaktohen me ligj. Me ligj mund të krijohen zona zgjedhore plurinomiale dhe uninomiale dhe të përkufizohet natyra dhe komplementariteti i tyre, në atë mënyrë që të sigurohet që votat të shndërrohen në ulëse në përputhje me sistemin e përfaqësimit proporcional dhe duke përdorur rregullën e d'Hondt-it për mesataren – më të lartë.

2. Me përjashtim të zonës zgjedhore kombëtare, nëse ka të tillë, numri i deputetëve për secilën zonë zgjedhore plurinomiale në territorin e Portugalisë duhet të jetë proporcional me numrin e qytetarëve të regjistruar me të drejtë vote.

Neni 173 Seanca pas zgjedhjeve

1. Kuvendi i Republikës së duhet të mbledhet në ditën e tretë pas llogaritjes së rezultateve të përgjithshme të zgjedhjeve apo, në rast të zgjedhjeve të organizuara për shkak se një legjislaturë po e përfundon mandatin dhe se dita e tretë në fjalë bie para përfundimit të mandatit të legjislaturës në fjalë, në ditën e parë të legjislaturës vijuese.

2. Në rast se ajo datë bie kur Kuvendi nuk është në përbërje të plotë, seanca duhet mbajtur për qëllimet e nenit 175.

Neni 180 Grupet parlamentare

1. Deputetët e zgjedhur nga secila parti ose koalicion i partive mund të formojnë grup parlamentar.

2. Secili grup parlamentar ka të drejtat në vijim:

a. Të marrë pjesë në komisionet e Kuvendit në raport me numrin e deputetëve tij dhe të emërojë përfaqësuesit e vet në komisione të tilla;

b. Të konsultohet për krijimin e rendit të ditës dhe të apelojë gjatë seancës Plenare kundër rendit të tillë të ditës;

c. Të iniciojë mbajtjen e debateve urgjente për çështjet me interes publik urgjent ku duhet të merr pjesë Qeveria;

d. Gjatë secilës seancë legjislative, të ngrit mbajtjen e dy debateve për çështjet e politikave të përgjithshme apo sektoriale duke ftuar Qeverinë për pjesëmarrje në Kuvend;

e. Të kërkojë nga Komisioni i Përhershëm që të ndërmerrë hapat për thirrjen e seancës Plenare;

f. Të iniciojë formimin e komisioneve parlamentare hetimore;

g. Të iniciojë ligje;

h. Të paraqesë mocione për refuzimin e Programit Qeveritar;

i. Të paraqesë mocione për mosbesim ndaj Qeverisë;

j. Të informohen rregullisht dhe drejtpërdrejtë nga ana e Qeverisë për situatën dhe mbarëvajtjen e çështjeve kryesore me interes publik.

3. Secili grup parlamentar ka të drejtë të disponojë me vendet ku do të punojë në selinë e Kuvendit, së bashku me stafin teknik dhe administrativ të zgjedhur prej tij, siç përcaktohet me ligj.

4. Deputetëve që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar u sigurohet një minimum i të drejtave dhe garancive të përcaktuara me Rregulloren e punës.

91. Rregullorja e punës e Kuvendit të Portugalisë, në Kapitullin II, përcakton:

KAPITULLI II

Grupet parlamentare

Neni 6

Formimi i grupeve parlamentare

1- Deputetët e Kuvendit të Republikës, të zgjedhur nga secila parti ose koalicion i partive mund të formojnë grup parlamentar.

2- Secili grup parlamentar formohet duke i dorëzuar Kryetarit të Kuvendit një njoftim, të nënshkruar nga deputetët e Kuvendit të Republikës, të cilët e përbëjnë grupin parlamentar dhe ky njoftim duhet të përmbajë emrin e grupit, Kryetarin e grupit dhe nënkryetarin, nëse ekziston.

3- Grupet parlamentare e njoftojnë Kryetarin e Kuvendit për çdo ndryshim në përbërjen e grupit apo në udhëheqësin e tij.

4- Njoftimi i referuar në paragrafët e mësipërm (2) dhe (3) duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare.

Neni 13

Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

1 – Propozimet për Kryetar të Kuvendit të Republikës duhet të nënshkruhen nga të paktën një e dhjeta dhe nga më së shumti një e pesta e të gjithë deputetëve.

2 – Propozimet i dorëzohen Kryetarit në detyrë së paku dy orë para momentit kur bëhet zgjedhja.

3 – Zgjedhja bëhet gjatë seancës së parë plenare të secilës legjislaturë.

4 – Kryetar i Kuvendit zgjidhet kandidati që merr një shumicë absolute të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës gjatë ushtrimit të plotë të mandatit të tyre.

5 – Nëse asnjë kandidat nuk merr atë numër të votave, duhet që menjëherë të mbahet votimi i dytë vetëm për dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave dhe që nuk i kanë tërhequr propozimet e tyre.

6 – Nëse nuk zgjidhet asnjë kandidat, procesi fillon nga e para.

Slovenia

92. Kushtetuta e Sllovenisë, në nenin 84, përcakton:

Neni 84 Kryetari i Kuvendit Kombëtar

Kuvendi Kombëtar ka një kryetar i cili zgjidhet më shumicën e votave të të gjithë deputetëve.

93. Rregullorja e punës së Kuvendit Kombëtar të Sllovenisë, në Kapitullin II, përcakton:

II. KONSTITUIMI I KUVENDIT KOMBËTAR

Neni 9

Kuvendi konstituohet gjatë seancës së parë në të cilën konfirmohet zgjedhja e më shumë se gjysmës së deputetëve.

Neni 10

(1) Jo më vonë se pesë ditë nga seanca e parë e Kuvendit, Kryetari në detyrë i Kuvendit thërret takimin me udhëheqësit e përkohshëm të grupeve të deputetëve dhe deputetëve nga komunitetet kombëtare për të përcaktuar draft rendin e ditës së seancës së parë, renditjen e ulëseve të deputetëve në sallën e kuvendit, grupet parlamentare anëtarët e të cilave do të bartin pozitën e kryesuesve dhe zëvendës kryesuesve në Komisionin për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime dhe numrin a anëtarëve të këtij komisioni që i përkasin grupeve të caktuara parlamentare dhe mundësisht edhe përcaktimi i grupeve deputetëve anëtarët e të cilave do të bartin pozitën e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit në grupet tjera punuese si dhe numrin e anëtarëve të atyre grupeve punuese që i përkasin grupeve të caktuara deputetëve.

(2) Në pritje të formimit të Këshillit të Kryetarit të Kuvendit Kombëtar, udhëheqësit e përkohshëm të grupeve të deputetëve dhe dy deputetë nga komunitetet kombëtare, vendosin për propozimet nga pika e parë, e dytë dhe e katërt e paragrafit gjashtë të nenit 21 të kësaj Rregullore të Punës dhe mund të propozojnë një kandidat për Sekretar të Përgjithshëm të Kuvendit Kombëtar.

(3) Rendi i ulëseve të deputetëve në sallë përcaktohet përmes marrëveshjes mes grupeve të deputetëve. Nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje, rendi i ulëseve përcaktohet në atë mënyrë që ulëset e deputetëve në mesin e ulëseve të lira deputetëve përcaktohen nga grupet e deputetëve sipas rendit nga grupi më i madh deri tek grupi më i vogël e deputetëve. Grupeve të deputetëve me numër të njëjtë të anëtarëve, përmes shortit paraprak, iu përcaktohet renditja e ulëseve të deputetëve.

Neni 11

(1) Deri në formimin e grupeve të deputetëve, në përputhje me nenin 16 të kësaj Rregullore të punës, grupet parlamentare përbëhen nga deputetët e zgjedhur në Kuvend nga lista e njëjtë e kandidatëve, deputetëve të zgjedhur nga lista e votuesve dhe deputetëve që përfaqësojnë komunitetet kombëtare. Përbërja e grupeve të deputetëve është e përcaktuar mbi bazën e raportit për rezultatet e zgjedhjeve.

(2) Jo më vonë se tri ditë pas publikimit të raportit për rezultatet e zgjedhjeve, përfaqësuesit e listave i dërgojnë emrat e udhëheqësve të përkohshëm të grupeve të deputetëve nga paragrafi paraprak të Kryetarit në detyrë të Kuvendit Kombëtar.

Neni 12

(1) Përgatitjet për seancën e parë të Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit në detyrë të Kuvendit.

(2) Udhëheqësit e përkohshëm të grupeve të deputetëve e informojnë Kryetarin në detyrë të Kuvendit për kandidatët e propozuar për Kryetar, Nënkryetar dhe anëtarë të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime.

(3) Drafti i rendit të ditës së seancës së parë përfshin emërimin e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime, konfirmimin e zgjedhjes së deputetëve dhe zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe mund të përfshijë edhe zgjedhjen e Nënkryetarëve të Kuvendit dhe emërimin e kryesuesve dhe zëvendëskryesuesve të grupeve punuese si dhe emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

(4) Deri në zgjedhjen e Kryetarit, seancën e parë të Kuvendit e kryeson deputeti më i vjetër.

Neni 13

(1) Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime shqyrton raportin e rezultateve të zgjedhjeve, konfirmimin e deputetëve të zgjedhur dhe çdo ankesë të kandidatëve apo përfaqësuesve të listës së kandidatëve.

(2) Kuvendi Kombëtar vendos për konfirmimin e zgjedhjes së deputetëve mbi bazën e raportit të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërime lidhur me vlerësimin dhe konfirmimin e zgjedhjeve dhe përmbajtjen dhe pranueshmërinë e çfarëdo ankese nga kandidatët apo përfaqësuesit e listës së kandidatëve.

(3) Kuvendi Kombëtar, në mënyrë kolektive, vendos për konfirmimin e zgjedhjeve që nuk janë të kontestuara dhe për secilën zgjedhje të kontestuar veç e veç.

(4) Një deputet, zgjedhja e të cilit ende kontestohet nuk mund të votojë për konfirmimin e zgjedhjes së tij.

(5) Duke vendosur për një zgjedhje të kontestuar, konsiderohet se Kuvendi ka vendosur edhe për çdo ankesë të parashtruar pranë Kuvendit nga ana e një kandidati ose përfaqësuesi të listës së kandidatëve.

Neni 14

Pas konfirmimit të këtyre zgjedhjeve, Kuvendi Kombëtar zgjedh Kryetarin e Kuvendit Kombëtar.

Neni 15

Nëse gjatë seancës së parë Kuvendi dështon në zgjedhjen e Nënkryetarëve të Kuvendit Kombëtar dhe në emërimin e kryesuesve dhe zëvendës kryesuesve të grupeve punuese dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit Kombëtar, ky i fundit duhet t'i zgjedh apo emëron ata jo më vonë se 30 ditë pas konstituimit të tij.

Neni 16

Deputetët formojnë grupet të deputetëve në pajtim me nenin 29 të kësaj Rregulloreje të punës jo më vonë se shtatë ditë pas konstituimit të Kuvendit Kombëtar.

Neni 17

Dispozitat e nenit 13 të kësaj Rregulloreje të punës vlejnë mutatis mutandis edhe për procedurën e konfirmimit të zgjedhjes së një deputeti që e zëvendëson një deputet mandati i të cilit ka skaduar apo një deputet mandati i të cilit është ndërprerë për shkak të zgjedhjes së tij Kryeministër apo është emëruar për ministër.

Baza relevante juridike për kërkesën

94. Neni 67 (1 - 3) [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] i Kushtetutës parasheh:

“1. Kuvendi i Kosovës, nga radhët e veta, zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.

2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

3. Tre (3) nënkryetarët e propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.”

95. Neni 64 (1) [Struktura e Kuvendit] i Kushtetutës parasheh:

“Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive,

koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.”

96. Kreu III i Rregullores së punës të Kuvendit parasheh si në vijim:

“KREU III - Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit

Neni 7

Mbledhja konstituive e legjislaturës së Kuvendit

Mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.

Neni 8

Përgatitja e mbledhjes konstituive e legjislaturës së Kuvendit

1. Përgatitjet për mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit nga legjislatura e mëparshme.

2. Kryetari dhe Kryesia, jo më pak se pesë ditë para mbajtjes së mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit thërrasin mbledhje të përbashkët me kryetarët e partive, që kanë fituar vende në Kuvend, për ta përgatitur propozimin e rendit të ditës për mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit, për t'i caktuar vendet e deputetëve, përkatësisht të forcave politike në sallë, sipas fuqisë politike që kanë, sipas numrit të deputetëve të secilës forcë politike.

3. Nëse dy apo më shumë grupe parlamentare kanë numër të njëjtë të deputetëve, atëherë renditja e tyre në sallë bëhet me short.

4. Rendi i ditës i mbledhjes konstituive të legjislaturës duhet ta përfshijë formimin e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit, të mandateve, zgjedhjen e kryetarit dhe të pesë (5) nënkryetarëve të Kuvendit.

Neni 9

Kryesimi i mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit

1. Punimet e mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit, deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit, i udhëheq deputeti më i vjetër, i ndihmuar nga deputeti më i ri, sipas moshës.

2. Nëse deputeti, përkatësisht deputetët nga paragrafi 1 e këtij neni, mungojnë në mbledhjen konstituive ose e refuzojnë kryesimin e mbledhjes, atëherë angazhohen deputetët të cilët, sipas moshës, vijnë menjëherë pas tyre.

3. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës së Kuvendit, pas hapjes së mbledhjes dhe paraqitjes së rendit të ditës, kërkon nga partitë politike të

përfaqësuar në Kuvend ta caktojnë nga një përfaqësues në Komisionin e përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve.

4. Komisioni i përkohshëm e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, ia paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe e verifikon kuorumin në mbledhjen konstituive të legjislaturës së Kuvendit.

Neni 10 Betimi i deputetëve

1. Pas verifikimit të mandateve, deputetët betohen solemnisht. Teksti i deklaratës është:

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!”.

Deklaratën e betimit e lexon kryesuesi i mbledhjes. Deputetët betohen, duke e shqiptuar në fund të deklaratës, fjalën “Betohem!”. Secili deputet e nënshkruan deklaratën e betimit.

2. Deputeti, që mungon në mbledhjen konstituive të legjislaturës, kur bëhet betimi, betimin e bën në mbledhjen e parë të radhës.

Neni 11 Mandati i Kuvendit

1. Kuvendi zgjidhet me mandat katërvjeçar. Mandati fillon nga mbledhja konstituive, e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Mandati i Kuvendit mund të vazhdohet vetëm në rastet e parapara sipas nenit 66, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 12 Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

1. Në mbledhjen konstituive të Legjislaturës IV, Kuvendi nga radhët e veta i zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarët. Kryetari dhe nënkryetarët e përbejnë Kryesinë e Kuvendit.

2. Kryesuesi i mbledhjes konstituive kërkon nga grupi më i madh parlamentar ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

3. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës kërkon nga tri grupet më të mëdha parlamentare ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetarë të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

4. Në përbërje të Kryesisë dhe në trupat e tjerë të punës të Kuvendit respektohet përbërja gjinore e Kuvendit.

5. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës kërkon nga deputetët që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Nënkryetarët, sipas kësaj pike, zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

6. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës e shpall rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit. Kryetarin e sapozgjedhur të Kuvendit e fton ta zërë vendin e tij.”.

97. Gjykata vëren se, lidhur me seancën e parë të thirrur pas zgjedhjeve parlamentare, versioni anglisht i Kushtetutës përdor termin “seancë konstituive” (neni 66, paragrafët 1 dhe 3 [Zgjedhja dhe Mandati] i Kushtetutës) ndërsa Rregullorja e punës e Kuvendit përdor termin “inauguration of the Assembly” (inaugurimi i Kuvendit) (titulli i Kreut III) dhe “inaugural session” (seancë inaugurues) (nenet 7, 8 dhe 9). Versioni shqip i Kushtetutës përdor shprehjen “seancë konstituive” (neni 66, paragrafi 1 dhe 3 [Zgjedhja dhe Mandati] i Kushtetutës), kurse Rregullorja e punës e Kuvendit përdor “KONSTITUIMI I LEGJISLATURËS” (titulli i Kreut III) dhe “konstituive e legjislaturës” (nenet 7, 8 dhe 9). Gjykata konsideron se shprehja “constitutive session” (seancë konstituive) shërben më mirë për qëllime të qartësisë. Prandaj, Gjykata e ka përdorur dhe do të përdorë termin kushtetues “Seancë konstituive”, që do të thotë seanca e parë e thirrur pas zgjedhjeve parlamentare.

Meritat e kërkesës

98. Parashtruesit e kërkesës ankohen se procedura e ndjekur nga 83 deputetë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit ishte në kundërshtim me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], të Kushtetutës, dhe me Kreun III [Konstituimi i Legjislaturës së Kuvendit] të Rregullores së punës të Kuvendit. Pra, sipas këndvështrimit të parashtruesve, vendimi i 83 deputetëve, me të cilin z. Isa Mustafa u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është jokushtetues.
99. Gjykata vëren se kërkesa ka të bëjë me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit sipas nenit 67 (2) [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton se “Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”.
100. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të vlerësojë faktet e rastit të veçantë, por të vlerësojë nëse pretendimet e lartpërmendura kanë ngritur apo jo çështje kushtetuese sipas dispozitës përkatëse kushtetuese. Rrjedhimisht, në rastin e

tanishëm, Gjykata do të merret vetëm me çështje të natyrës kushtetuese të ngritura në bazë të nenit 67 (2) të Kushtetutës dhe në bazë të dispozitave të tjera të ndërlidhura.

101. Gjykata vëren se, në rastet e mëparshme, kur është bërë fjala për interpretimin e dispozitave kushtetuese, ka kërkuar shumë herë që t'i dorëzohen *Travaux Preparatoires*, në mënyrë që të njihet me qëllimin e hartuesve të Kushtetutës. Rezultati gjithmonë ka qenë që *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës nuk janë në dispozicion. Për pasojë, Gjykata ka vendosur që, në mungesë të *Travaux Preparatoires* të Kushtetutës, duhet ta bëjë interpretimin vetë (Shih, për shembull, rastin KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2014).
102. Prandaj, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundime lidhur me qëllimet e hartuesve të Kushtetutës dhe nuk mund të spekulojë se çfarë kanë dashur të thonë ata. Për më tepër, çfarëdo krahasimi ose çfarëdo marrje e argumenteve nga Korniza Kushtetuese e Kosovës e vitit 2001 vështirë se është relevante. Korniza Kushtetuese ka qenë në fuqi deri më 15 qershor 2008 për të rregulluar një situatë tjetër. Më 9 prill 2008, u miratua Kushtetuta e re moderne dhe zbatohet në shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës nga 15 qershori 2008.
103. Rrjedhimisht, Gjykata do të bëjë interpretimin e nevojshëm të nenit 67 (2) [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkrjetarëve] të Kushtetutës.
104. Si vërejtje paraprake, Gjykata vëren se, për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe për formimin e Qeverisë, Kushtetuta përdor shprehje të ndryshme për të njëjtin realitet. Shprehje të ndryshme konkretisht janë: *Vendet (...) ndahen (...) në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara (...) në zgjedhjet (...) [(Neni 64 (1) i Kushtetutës), grupi më i madh parlamentar [Neni 67 (2) i Kushtetutës), partia politike ose koalicioni, që përbën shumicën e Kuvendit [Neni 84 (14) i Kushtetutës), partia politike ose koalicioni që ka fituar shumicën në Kuvend [Neni 95 (1) i Kushtetutës]*.
105. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata do të mbështetet në nenin 64 (1) [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës. Ky nen parasheh: *“Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin”*.
106. Gjykata vëren se nenet e lartpërmendura 64 (1) dhe 67 (2) të Kushtetutës janë bazë juridike për strukturimin dhe konstituimin e Kuvendit dhe Kreu III i Rregullores së punës të Kuvendit shërben si mjet dhe si mekanizëm procedural për implementimin e këtyre dispozitave kushtetuese.
107. Në këtë drejtim, Gjykata vëren, së pari, se Rregullorja e punës për zhvillimin e seancës konstitutive të Kuvendit u miratua më 29 prill 2010; ajo është në fuqi dhe duhet të aplikohet, përfshirë edhe në raport me rendin e ditës.

108. Së dyti, Gjykata vëren se qëllimi i seancës konstituive të Kuvendit është ndërtimi i legjislaturës së re pas zgjedhjeve, me ndihmën procedurale të Kryetarit të legjislaturës së mëparshme, mandati i së cilës kishte përfunduar para se të mbaheshin zgjedhjet e reja parlamentare. Kuvendi ndërtohet nëpërmjet verifikimit dhe konfirmimit të mandatit të deputetëve, dhënies së betimit nga deputetët dhe nëpërmjet zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit (Shih nenin 8, paragrafi 4, nenin 10 dhe nenin 12 të Rregullores së punës të Kuvendit).
109. Së treti, Gjykata vëren se seanca konstituive e Kuvendit nuk mund të konsiderohet se është realizuar plotësisht, nëse Kuvendi nuk e ka zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.
110. Gjykata konsideron më tej se Kryesuesja që e kryeson seancën konstituive, edhe pse nuk është e zgjedhur, ajo është e obliguar me Kushtetutë dhe me Rregullore të punës të Kuvendit, për të realizuar Seancën konstituive.
111. Me qëllim të vlerësimit se a ka qenë kushtetuese zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, Gjykata do të interpretojë kuptimin e “grupit më të madh parlamentar”, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës. Ky interpretim është i rëndësishëm kruciale pasi ka të bëjë me atë se kush mund të propozojë Kryetarin e Kuvendit.
112. Gjykata vëren se nenit 67 (2) të Kushtetutës i paraprin neni 64 (1) i Kushtetutës. Që të dy dispozitat janë të ndërlidhura dhe duhet të merren parasysh së bashku.
113. Kushtetuta, në nenin 64 (1), përcakton se, me rastin e strukturimit të Kuvendit, vendet duhet të ndahen në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhjet për Kuvend. Ndarja bëhet ndërmjet partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në proporcion me rezultatet në zgjedhje parlamentare. Kjo do të thotë se partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur u jepet ai numër i vendeve, barazuar me mandate të deputetëve, që korrespondon proporcionalisht me votat që kanë fituar në zgjedhje, duke pasur parasysh se këto parti, koalicione, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur kanë kaluar pragun. Kushtetuta i jep prioritet rezultateve të zgjedhjeve si kriter. Kjo vlen për parti dhe për koalicione që janë regjistruar si të tilla për të marrë pjesë në zgjedhje, si dhe për iniciativa qytetare dhe për kandidatë të pavarur.
114. Gjykata rithekson se *“përdorimi i termeve ‘parti politike ose koalicion’ kur përmenden në lidhje me nenin 84 (14) dhe nenin 95 paragrafi 1 dhe 4 të Kushtetutës nënkuptohet partia politike ose koalicioni që është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, merr pjesë si subjekt zgjedhor, është i përfshirë në fletëvotim të zgjedhjeve, e kalon pragun dhe, kështu fiton vende në Kuvend”* (Shih rastin KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2014).
115. Për më tepër, Gjykata vendosi që *“[...] partia politike ose koalicioni mund të jetë vetëm ajo që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje, respektivisht numrin më të madh të vendeve në Kuvend.”* (Shih rastin

KO103/14, Presidentja e Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 1 korrikut 2014).

116. Rrjedhimisht, grupi më i madh parlamentar, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës, duhet të konsiderohet partia, koalicioni, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë më shumë vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64 (1) të Kushtetutës, se çdo tjetër parti, koalicion, iniciativë qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë marrë pjesë si të tillë në zgjedhje. Ky grup duhet ta propozojë Kryetarin e Kuvendit, duke respektuar dispozitat e nenit 67 (2) të Kushtetutës. Kjo është ajo që parasheh Kushtetuta si grup parlamentar dhe, aq më tepër, që kjo është *de facto* në pajtim me praktikën parlamentare në shtetet demokratike.
117. Një argument shtesë është se grupi parlamentar, në kuptimin më të ngushtë të fjalës (*in stricto sensu*), dhe sipas Rregullores së punës të Kuvendit e Shtojcave të saj, mund të regjistrohet vetëm pas konstituimit të Kuvendit, pra, pas zgjedhjes së Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit.
118. Në momentin e thirrjes së seancës konstituive të Kuvendit, grupi parlamentar përbëhet nga kandidatë që janë zgjedhur anëtarë të Kuvendit në fletëvotimin e partisë, tëkoalicionit, të iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që janë regjistruar për zgjedhje, kanë marrë pjesë në to, e kanë kaluar pragun ligjor dhe kanë fituar vende në proporcion me numrin e votave të vlefshme të fituara në zgjedhjet për Kuvend.
119. Në rastin e tanishëm, Kryesuesja e seancës konstituive, më të drejtë ia dha mundësinë grupit më të madh parlamentar të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit, pasi që, sipas listës së rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve, partia e cila ishte e para në renditje i kishte 37 deputetë. Rrjedhimisht, po t'i ishte dhënë mundësia ndonjë partie tjetër, ndonjë koalicioni tjetër, ndonjë iniciativë tjetër qytetare dhe kandidatëve të tjerë të pavarur, do të ishte jokushtetuese.
120. Gjykata vëren se, sipas transkriptit, pas pezullimit të seancës konstituive për shkak të mungesës së kuorumit, një grup i deputetëve thirri një mbledhje për të parashtruar mocion për zëvendësimin e Kryesueses dhe ata zgjodhën Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.
121. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e kësaj procedure dhe rezultatin e saj. Duke marrë parasysh interpretimin e lartpërmendur në bazë të nenit 67 (2), në lidhje me neni 64 (1), dhe në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit, Gjykata gjen se kjo mbledhje e kontestuar nuk është në pajtim me kërkesat kushtetuese që një seancë konstituive të konsiderohet kushtetuese. Kështu, kjo mbledhje nuk duhet të konsiderohet seancë konstituive.
122. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se vendimi, si rezultat i kësaj mbledhjeje, nuk korrespondon me një vendim të marrë, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës, gjatë seancës konstituive dhe, nga grupi më i madh parlamentar. Për pasojë,

Vendimi Nr. 05-V-001, i votuar nga 83 deputetë të Kuvendit për zgjedhjen e z. Isa Mustafës Kryetar të Kuvendit, i 17 korrikut 2014, është i pavlefshëm.

123. Gjykata rithekson se zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe e deputetëve është parakusht që Kuvendi të fillojë të funksionojë si organ legjislativ. Kjo kërkon nga të gjithë deputetët që të jenë të pranishëm dhe të votojnë, në mënyrë që të konstitujnë Kuvendin. Në rastin KO29/11, Gjykata vendosi që “[...]Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit [...]”. Për më tepër, lidhur me obligimin e tyre si deputetë, neni 74 [Ushtrimi i funksionit] i Kushtetutës siguron: “deputetët e Kuvendit të Kosovës do të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së punës së Kuvendit.” (Shih, Rasti KO29/11, Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë në kërkesën për Vlerësim të kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 22 shkurt 2011, Aktgjykim i 30 marsit 2011).
124. Për më tepër, Gjykata rikujton se votimi në Kuvend mund të bëhet në mënyra të ndryshme: duke votuar “për”, “kundër” ose duke abstenuar; me votim të hapur ose me votim të fshehtë; apo në çfarëdo mënyre tjetër (Shih paragrafin 4 të nenit 51 [Kuorumi dhe votimi në mbledhjet e Kuvendit], të Rregullores së punës të Kuvendit).
125. Gjykata konsideron se mënyrat e ndryshme të votimit kanë për qëllim të sigurojnë shprehjen demokratike dhe të pavarur të vullnetit të deputetëve dhe të sigurojnë të drejtat e deputetëve në mënyrë që ata t’u përmbahen obligimeve të tyre.
126. Gjykata vëren se askund në Kushtetutë nuk parashihet që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të shkaktonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.
127. Është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit, në pajtim me dispozitat kushtetuese në lidhje me Rregulloren relevante të Kuvendit dhe të bëjnë Kuvendin funksional.
128. Në konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë si të dëshirojnë, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, të votojnë “për”, “kundër” ose të abstenojnë, dhe nuk mund të lirohen nga të vepruarit kështu.
129. Gjykata rithekson se vendimi i saj është bazuar në objektin e çështjes së kërkesës, siç është përmendur në paragrafët 3 dhe 4 të këtij aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, në bazë të nenit 42 dhe të nenin 43 të Ligjit, dhe në bazë të rregullit 56.1 të Rregullores së punës, më 21 gusht 2014,

VENDOSI

- I. njëzëri, të DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. me shumicë votash, TË KONSTATOJË, që:
 - a. mbledhja dhe procedura e ndjekur pas pezullimit të seancës konstituive, më 17 korrik 2014, nga Kryesuesja, për shkak të mungesës së kuorumit, kanë shkelur nenin 67 (2), në lidhje me nenin 64 (1), të Kushtetutës dhe Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene;
 - b. Vendimi Nr. 05-V-001, i 17 korrikut 2014, është jokushtetues, si për nga procedura e ndjekur, ashtu edhe për nga përmbajtja, pasi nuk ishte grupi më i madh parlamentar ai që propozoi Kryetarin e Kuvendit dhe, rrjedhimisht, është i pavlefshëm;
 - c. Seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar më 17 korrik 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit. Rrjedhimisht, Kuvendi duhet ta përfundojë seancën konstituive, duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët në pajtim me nenin 67 (2), në lidhje me nenin 64 (1), të Kushtetutës dhe me Kreun III të Rregullores së punës që zbaton këto nene dhe në pajtim me këtë aktgjykim;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani